



TV ALB GËZON SHQIPTARËT E AMERIKËS DHE KANADASË

TASH NDIHEMI SI NË TIRANË, PRISHTINË, TETOVË, PRESHEVË, TUZ E ULQIN

New York - NY

TV ALB-a, tani nëpërmjet një pako e parë e kanaleve televizive shqiptare, ka filluar emntimin televiziv edhe në SHBA dhe Kanada. Janë më se 10-15 kanale televizive nga Shqipëri, Kosova, e disa vise të tjera shqiptare në Ballkan, që tani mund të shihet lehtë edhe në SHBA dhe Kanada përmes pakos TV ALB. Një pako e parë, kjo e kanaleve televizive shqiptare. TVALB, është në kuadër të kompanisë shqiptaro-amerikane për shërbime të IPTV-së (Internet Protocol Television). Abonimi në SHBA dhe Kanada mund të bëhet përmes faqes së internetit (www.tvalb.com), ose përmes telefonit: 1-201 880 9007. TV ALB, po shihet tek teleshikuesit dhe abonetët e saj anembanë SHBA, si një ndër të parat pako e kanaleve televizive shqiptare, në Amerikë, duke shënuar dhe ndryshimin më të madh në historinë e transmetimeve televizive shqiptare, madje edhe në një koncept më të gjerë, me një larmi programacioni dhe interaktivitet përmes transmetimeve televizive. Kështu TV ALB, nëpërmjet pakos së kanaleve televizive shqiptare, ka arrirë të thyejë një-pas-njëshëm kufijtë e transmetimeve televizive, duke qenë gjithnjë e më e kërkuar në mërgatën shqiptare, fakt ky i mishëruar në kërkesën gjithnjë e në rritje, përftuar nga shërbimet televizive të një pako e parë e kanaleve televizive shqiptare në SHBA-ës.

Kjo gjë, nxitet nga një fakt shumë i rëndësishëm dhe mjaft domethënës. Përveç perfeksionit në cilësinë e transmetimeve, TV ALB ka ç'është ofrojë maksimalisht në përmbajtjen e tyre duke siguruar kështu akses dhe absorbim të plotë të produkteve nga audiencia e saj...Platforma TV ALB përbëhet nga 10 kanale televizivë që përfshijnë gjithë gamën e produkteve televizivë; në Lajme, Aktualitet, Shkencë, Kulturë, Sport, Kinema, Dokumentarë, Muzikë, Programe për fëmijë dhe të rinj, ku gjithçka është ekskluzive si me qenë në Tiranë, Prishtinë, Tetovë, Preshevë, Tuz e Ulqin etj.

Përrurimi i TV ALB në Nju Jork:

Përrurimi i TV ALB, u bë në praninë e më shumë se 120 mysafirëve të ftuar, në mesin e përfaqë-

suesve të organizatave të komunitetit, biznesmenëve dhe bashkatdhetarëve, kompania prestigjioze TV ALB me në krye z. Benjamin Dreshaj, bëri promovimin e sinjalit të 10 stacioneve televizive në Amerikë dhe Kanada. Mbrëmja ekskluzive u mbajtë me 19 korrik 2007 në restorantin luksoz "Mario's" në Bronx, New York.

Në këtë mbrëmje Koktel, ishin të pranishëm nënkryetari i "Vatrës" Dr. Gjon Buçaj, kryetari i LDD-së dhe nënkryetar i "Vatrës" Agim Rexhaj, kryetari i LDK-së Ramadan Gashi, kryetari i Këshillit të Kishës "Zoja e Shkodrës" Marjan Cubi, biznesmeni dhe aktivisti i dalluar Zef Balaj, pronarja e restorantit "Lumi" Lumi Hadri, kryetari i Shoqatës Atdhetare Dibrane Ibrahim Kolari, biznesmeni dhe pronari i kompanisë ajrore "Adriatic Eagle Air" Tom Ulaj, redaktori i gazetës kombëtare "Bota Sot" Dervish Jahjaga, presidenti i "Albanian Yellow Pages" Ismer Mjeku, pronari i kompanisë "Albanian Limousine" Anton Gjokaj, këngëtarët e mirënjohur Merita Halili dhe Agim Gërbeshi, aktivistja Majlinda Myrto, aktivistja Shqipe Biba, pronari i kompanisë "Louis Overseas" Luigj Shkreli, poetja Kozeta Zylo, pronarja e kompanisë "Vesa Travel" Vesa Bardhi, Radio Melosi me në krye Edmond Pruthin dhe Berat Gashin e shumë e shumë të tjerë. Të lartë përmendurit folën fjalë miradie për kompaninë mediale "TV ALB" duke i uruar suksese dhe njëherit të gjithë bënë apel që çdo familje shqiptare në SHBA dhe Kanada të abonohej në rrjetin e TV ALB-it. Kjo mbrëmje ishte e bashkë organizuar me Radio Televizionin e Kosovës (RTK), ku në emër të RTK-së mysafirët i përshëndeti gazetari z. Sylejman Gashi korrespondent i RTK-së nga New Yorku. Poashtu një ekip i ardhur enkas nga RTK-ja në Prishtinë e bëri inçizimin e mbrëmjes dhe mori disa intervista me të pranishmit. Të gjithë të pranishmit shprehnin gëzimin që fëmijët e tyre tani e tutje në Amerikën e largët dhe Kanada kanë mundësinë që 24 orë të mësojnë dhe flasin gjuhën shqipe.

Beqir Sina